

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

CHEN FENGHUA

RECEPTIMI I GJENERALIT TË USHTRISË SË VDEKUR NË MEDIAT E REJA KINEZE*

1. Hyrje

Duke u nisur nga studimi i komunikimit, gjatë më shumë se njëqind vjetësh qysh nga fillimi i shekullit XX deri më sot, kanë dalë hap pas hapi në botë katër lloje mediash të mëdha: si shtypi, radioja, televizioni dhe interneti. Ato publikojnë dhe përhapin veprat letrare në mënyrat e tyre të ndryshme. Për shkak të dallimeve në grupe dhe mënyra, efekti i tyre i receptimit ndaj veprave letrare ndryshon. Sidomos pasi lindi interneti dhe u bë mjeti më i favorshëm në transmetimin e informacioneve, përhapja dhe receptimi i veprave letrare kanë shfaqur një ndryshim thelbësor që nuk ka ekzistuar më parë në procesin e komunikimit të letërsisë. Në këtë kumtesë, duke marrë si objekt studimi *Gjeneralin e ushtrisë së vdekur*, që u botua në Shqipëri në vitin 1963, do të përgjithësojmë dhe do të analizojmë situatën e receptimit të kësaj vepre të Ismail Kadaresë në mediat e reja kineze, shkurt në internetin kinez.

2. Përkthimi i romanit *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* dhe shfaqja e filmit *Kthimi i ushtrisë së vdekur në Kinë*

Sigurisht, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, romani më i njohur i Ismail Kadaresë, që është botuar deri më tani në më shumë se dyzet gjuhë, u përkthye dhe u bë i njohur në Kinë me shumë vonesë, por jo nëpërmjet mediave të reja kineze. Në fillim të viteve '90 leximi i librave në formën e shtypur ishte ende një kanal kryesor dhe i pazëvendësueshëm për të njohur një vepër letrare artistike. Në vitin 1992 përkthyesi dhe shkrimtari veteran kinez Zhen En Bo e përktheu direkt nga gjuha shqipe. Romanin e botoi shtëpia botuese *Shkrimtari*, një prej shtëpive botuese prestigjioze kineze, për t'u shërbyer shkrimtarëve kinezë si një vepër reference. Në të njëjtën periudhë kjo shtëpi botuese ka publikuar një vargu veprash nga letërsia botërore, duke u përfshirë kjo kryevepra e Kadaresë. Për arsye të tirazhit të kufizuar me 2500 kopje dhe të statusit të tij të veçantë në qarkullim, ky roman nuk pati ndikim në shumicën e lexuesve të thjeshtë kinezë.

Por më 1992, kanali i parë i televizionit qendror kinez (CCTV-1) shfaqti filmin *Kthimi i ushtrisë së vdekur*, realizuar nga regjisori i shquar shqiptar Dhimitër Anagnosti në vitin 1989 sipas këtij romanit. Siç përmend përkthyesi Zhen En Bo, ky film u shfaq i ndarë në dy pjesë dhe pati një jehonë të gjerë te shikuesit dhe te kritikët kinezë.¹ Në Kinën e viteve '90, megjithëse nuk kishte

* Kjo kumtesë është mbështetur nga projekti shkencor i Pekinit *Përkthimi dhe studimi për veprat letrare të Ismail Kadaresë*.

shumë kanale televizive si tani, shumica e familjeve qytetare ishin të pajisura me televizorë. Ishte ndërtuar një rrjet tepër i madh i TV shtetëror brenda vendit. Televizioni ishte bërë platforma më e preferuar për të njohur botën e jashtme dhe ndjekja e programeve televizive përbënte një pjesë të pazëvendësueshme e të pamungueshme të jetës së përditshme. Nëpërmjet programeve televizive formoheshin me shpejtësi yjet e telenovelave, telenovelat dhe filmat bëheshin të njohur për një natë në tërë Kinën. Prandaj pa dyshim qindra mijëra teleshikues kinezë e kanë parë këtë film, edhe pse nuk kemi një shifër të saktë për të.

Në vitin 2008 romanin e ribotoi Shtëpia Botuese *Chongqing*. Tre vjet rresht, para dhe pas vitit 2008, kjo shtëpi botuese, si të thuash, me një frymë ka hedhur në treg edhe dy romane të rëndësishme të Ismail Kadaresë, *Prilli i thyer* (2007) dhe *Pallati i ëndrrave* (2009). I pari është përkthyer nga botimi anglisht, i dyti nga botimi frëngjisht. Me fat, për herë të parë, lexuesit e thjeshtë kinezë kanë arritur të realizojnë dialogun me Ismail Kadarenë, përfaqësuesi i letërsisë bashkëkohore shqiptare, nëpërmes veprës së tij. Më vonë, në vitin 2012, *Huacheng*, një shtëpi tjetër botuese e madhe, nisi projektin për Kadarenë në gjuhën kineze, me emërtim “Seria e Evropës Lindore Blu”²; planifikoi që të përkthente një varg veprash letrare nga Evropa Lindore dhe Qendrore, duke u kushtuar më shumë vëmendje veprave klasike, qoftë të harruara, qoftë të reja, qoftë të ndaluara dhe të kritikuara sipas drejtimeve letrare të asaj kohe. Si rezultat i nismës për këtë projekt, janë botuar tri veprat e Kadaresë *Kronikë në gur*, *Kush e solli Doruntinën* dhe *Darka e gabuar*. Të dyja nismat e botimit janë sponsorizuar nga shteti kinez dhe për realizimin e tyre janë angazhuar dy nga shtëpitë botuese të fuqishme shtetërore. Përpjekjet e tyre i kanë dhënë tregut të librave tradicionalë kinezë një frymë të re artistike.

Duke u kthyer në fillim të viteve '90, botimi i romanit *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* dhe shfaqja e filmit përkatës duhen vlerësuar si nismë dhe sinjal i rëndësishëm, që u bënë të ditur kinezëve se në Shqipëri, përveç filmave të vjetër artistikë, që ishin mjaft të njohur atje, ka dhe dukuri të reja, që lidhen me një shkrimtar shumë të talentuar, i cili shquhet për narracion të veçantë, përfytyrime të çuditshme, metoda të pjekura dhe filozofi të thellë. *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, ka qenë vetë një surprizë e madhe, që Kadareja u bëri lexuesve vendas e të huaj në fillim të krijimtarisë së tij, në moshën 27-vjeçare.

3. Receptimi në mediat e reja kineze për Gjeneralin e Ushtrisë së Vdekur”

3.1 Receptimi në fushën studimore shkencore të romaneve të Kadaresë

¹ Zhen En Bo: *Doli Kadareja në Shqipëri*, parathënie romanit *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* në versionin kinez, shtëpia botuese *Chongqing*, 2008.

² Për lexuesit kinezë, mbiemri “blu” në këtë rast ka kuptimin e letërsisë së vendeve evropiane që janë të orientuara nga kultura perëndimore.

Receptimi i *Gjeneralit të ushtrisë së vdekur* në mediat e reja kineze

Sipas statistikave të uebsajtit (website) të burimeve studimore kineze³, që nga viti 1988 deri në vitin 2015, janë realizuar 48 punime shkencore dhe disertacione me objekt veprat e Ismail Kadaresë. 80 për qind prej tyre janë botuar pas vitit 2005, shumica prej tyre jep një analizë të përgjithshme për autorin Ismail Kadare dhe për veprat e tij. Një e katërta e këtyre punimeve dhe disertacioneve flet në mënyrë të drejtpërdrejtë për romane të tij të caktuara, ndër të cilat, *Prilli i thyer* dhe *Pallati i ëndrrave* janë dy veprat më të diskutuara. Për sa i përket shtimit të menjëhershëm të studimit për Kadarenë në Kinë, nuk mund të mohohet që kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm botimet e veprave të tij të përkthyer, pasi Kadareja fitoi çmimin “Man Booker International Prize” në konkurrim me autorë të shquar botërorë, si Gynter Grass, Gabriel Garcia Marquez, John Updike etj.

Në vitin 2014, studiuesja kineze prof. dr. Ke Jing, ka botuar monografinë e saj në gjuhën angleze me titull *Katër “të tjerë” në veprat e Ismail Kadaresë - studim për identitetin kombëtar shqiptar*⁴, e cila është e para monografi shkencore e mirëfilltë deri tani në Kinë për Ismail Kadarenë dhe veprat e tij. Në këtë studim ajo hulumton dhe analizon nga këndvështrimi i “katër të tjerëve”, domethënë “tjetri perëndimor”, “tjetri lindor”, “tjetri brenda vendit” dhe “tjetri nga vendet fqinje” që paraqiten në veprat e tij kryesore, duke kombinuar me sfondin politik dhe historik të kohës kur janë shkruar këto vepra, për të nxjerrë kështu në pah synimin politik të autorit, funksionin politik të letërsisë dhe thelbin politik në krijimtarinë e tij për të formuar identitetin kombëtar shqiptar. Kjo monografi na paraqet një këndvështrim të ri në studimet për veprat e Kadaresë dhe na ndihmon për të kuptuar më thellë marrëdhëniet e ngushta të pashmangshme midis letërsisë dhe politikës për shumicën e shkrimtarëve bashkëkohorë shqiptarë që kanë përjetuar regjimin komunist.

3.2 Receptimi i *Gjeneralit të ushtrisë së vdekur* në mediat e re kineze

Ndryshe nga mediat tradicionale në thelb, mediat e reja në internet dallohen me diversitetin, individualitetin, ndërveprimin, universalin, shpejtësinë etj., siç është dhënë përcaktimi i revistës amerikane “Wired” për mediat e reja, “transmetimi i të gjithëve ndaj të gjithëve”. Duke u rrjetëzua komunikimi dhe kritika letrare, si vepra kineze ashtu botërore, veprat e Kadaresë debatohen dhe kritikohen gjithnjë e më shumë në internet. Nuk mjafton që të dëgjojnë lexuesit dhe shikuesit kinezë analizat profesionale të studiuesve ose kritikëve për vepra letrare, të parët, shumica prej tyre janë të rinj, duhet të shprehin pa durim zërat e vet, si pasojë, receptimi i letërsisë ka hyrë në një epokë më të larmishme dhe më të lirë, kudo në botë.

Uebsajtet kryesore me profil kulturor-letrar në Kinë, duke përfshirë www.book.douban.com, www.weibo.com, www.blog.sina.com.cn, www.blog.sohu.com etj., që funksionojnë si një platformë përbashkuese në internet,

³ Këtu shënohet faqja e specializuar për raportime zyrtare rreth studimeve në Kinë www.cnki.net, ku jepen punime, artikuj të mbi 7000 revistave dhe disertacione të instituteve që botohen në Kinë.

⁴ Shih bibliografinë.

për polemika të ndryshme letrare, me qëllim që të tërheqin efektivisht të interesuarit për çështje të letërsisë. Pjesëmarrësit në debat rreth këtyre tematikave shprehin në çdo kohë, në çdo vend idetë e tyre të personalizuar për t'i komunikuar me njëri-tjetrin. Këto ide ose thjesht komente, pritet të mbështeten ose të kundërshtohen nga lexuesit më të gjerë, kështu që temat përkatëse mund të bëhen të debatuar nëse thithin shumë vëmendje brenda një kohe të shkurtër. Natyrisht shumica e pjesëmarrësve janë lexues të thjeshtë, por ka rast që janë edhe kritikë dhe shkrimtarë profesionistë ose të vetëformuar; sidomos për vepra letrare jo shumë të përhapura, si ato të letërsisë shqipe në Kinë, pjesëmarrësit mund të jenë më të veçantë, më të shkolluar, me një horizont më të gjerë ndaj letërsisë botërore. Gjithsesi, analizat e këtyre pjesëmarrësve nuk kryhen për asnjë qëllim fitimprurës, por nxiten nga kërkesa normale të komunikimit pas leximit ose shikimit. Prandaj ata nuk përfaqësojnë asnjë shtëpi botuese, asnjë institucion shkencor zyrtar, dhe pikërisht për këtë arsye, komentet e tyre janë deri diku më reale, më përfaqësuese për të mishëruar shumicën e mendimeve të lexuesve për një vepër të caktuar. Për të sqaruar në cilat aspekte janë fokusuar këta kritikë ose lexuesit kinezë në internet për sa i përket kësaj vepre konkrete, *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, mjafton të kujtohen dy raste përfaqësuese: njëri është titulluar *Në hijen e paskajshme të luftës - për romanin e Ismail Kadarese* “*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*” dhe mban nënshkrimin e blogistit Gaoxing⁵, tjetri është titulluar *Kadareja, romancier poetik tërheqës - komentet për “Gjeneralin e ushtrisë së vdekur”* dhe është nënshkruar nga një zonjë, Heilang⁶.

1) Pa habi, veçantia e këndvështrimit të këtij romani konsiderohet nga lexuesit kinezë në internet si një ndër karakteristikat e tij më të spikatura. Gaoxing vlerëson se “në këtë roman përshkruhet hija e luftës, jo lufta direkt, e cila dëmton psikikën e njerëzve, më ashpër sesa lufta vetë”. Tërë romanin e mbulon plotësisht hija e rëndë e luftës, të gjithë njerëzit kishin vuajtur nga lufta dhe vazhdonin të vuanin pa përjashtim nga hija e luftës në jetë dhe psikikë. Pa dyshim është ky tension i madh dhe i papërballueshëm që e çonte gjeneralin krenar italian përfundimisht në çmenduri. Heilang vlerëson se Kadareja “vështroi luftën nga varret”, riprodhon në mënyrë absurde historinë e luftës, për të dalluar goditjen e fortë shpirtërore që pësuan të dy popujt ndërluftues, urretjet e vazhdueshme që u shkaktuan nga tragjedia e luftës si dhe thelbin jonjerëzor të luftës. Kështu që do të ishte e pashmangshme humbja e gjeneralit përsëri në luftën shpirtërore mes atij dhe shqiptarëve të kohës së re, vetëkrenaria dhe poshtërimi i tij ndaj tyre u shembën dhe u shndërruan në dëshpërim, turpërim, zemërim dhe marrëzi.

2) Romani është i mbushur plot me shijet shqiptare. Heilang pohon se “Kadareja përziei njërin pas tjetrit me mjeshtëri artistike elementet historike, gjeografike, kulturore, folklorike në episode të ndryshme”. Ai na i bën të njohur shqiptarët si një komb tepër i veçantë, në sytë e gjeneralit, të një të huaji, të një ish-armiku, të një “tjetri”. Duket sikur detyra humanitare e gjeneralit përbën një

⁵ I publikuar në blogun e Gaoxing-ut në datën 7 shtator 2007, <http://blog.sina.com.cn/gaogaoxingxing>.

⁶ I publikuar në datën 20 mars 2011, në faqen www.douban.com.

Receptimi i *Gjeneralit të ushtrisë së vdekur* në mediat e reja kineze

udhërrëfyes të kujdesshëm për të zbuluar të kaluarën e luftës, për të diskutuar historinë e shqiptarëve dhe çështjet njerëzore më gjerë. Karakteret e popullit shqiptar në kontraste të tilla të vijueshme shquhen më shumë sesa nga një vështrim normal vendës. Nga njëra anë, ata duken të zakonshëm në pamje dhe deri diku të mërzitshëm, flasin shumë pak, por janë të thjeshtë për të jetuar në paqe dhe qetësi, zemërgjerë për të huajit, madje edhe për ata që kanë qenë armiq. Nga ana tjetër, ata janë një grup njerëzish për të cilët nderi është aq i shenjtë, saqë do të jepnin jetën për të me bindje e pa ngurrim. Kur përballen me fatkeqësi kombëtare ose familjare, ata do të shndërrohen në njerëz shumë të fortë dhe trima. Prandaj, ky roman plotëson kërkesat e lexuesve për të njohur kombin shqiptar, duke shkruar përtej një romani të zakonshëm kundër luftës në përgjithësi.

3) Nga teknika e krijimtarisë autori Kadare qysh në moshën 27-vjeçare ka arritur të ngrejë një strukturë të përsosur dhe kompakte në romanin *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* me temë luftën antifashiste, por të cilit i mungojnë skenat e mëdha të luftës: ato zëvendësohen me skena kërkimi eshtrash dhe gjurmimesh pas njëzet vjetësh. Ngjarjet që ndodhin në procesin e mbledhjes së eshtrave, sjellin në mënyrë të vazhdueshme një varg kujtimesh shumështresëshe për luftën e dhimbshme mes tyre. Dezertorët, vrasjet dhe aktet e dhunës mes ushtarëve italianë, skandali i Kolonelit Z, gjithçka e vërtetë zbulohet dalëngadalë duke u shoqëruar me zhvarrosjen e eshtrave të ushtarëve italianë. Siç vlerëson Gaoxing në blog, brenda strukturës së përgjithshme janë vendosur shumë episode të detajuara, në të cilat “me forma të ndryshme, si kujtime, dialogë, aluzione, ironi, shtjellime anash, meditime, përshkrime psikologjike etj., autori kontrollon gjithmonë ritmin e romanit”, kështu shkallë-shkallë e çon romanin në kulm kur, del papritur thesi me skeletin e kolonelit Z.

4) Në fragmentet e cituara duket vëmendja e lexuesve dhe kritikëve për këtë roman. Siç konsideron Heilang, në roman paraqitet aty-këtu “humori i zi i autorit”, i cili ka thyer atmosferën e mërzitshme monotone që mbizotëron, çka e bën lexuesin që të buzëqeshë jo rrallë bashkë me autorin sikur të kishin nënshkruar një marrëveshje të fshehtë. Në fund të romanit jepet një episod i bukur, që përmendet nga Heilang, ku gjenerali i dehur trokiste në derën e priftit në mesnatë, duke i përsëritur që ta fshihte faktin që thesi me skeletin e kolonelit Z u shtye në humnerë. Sipas gjeneralit të çmendur, ata do të gjenin lehtë një skelet me gjatësi prej 1.82 metrash, për të cilin do të qanin pa problem familjarët e kolonelit, se vetëm qielli dhe toka, ai dhe prifti e dinë të vërtetën. Tjetër fragment është përshkrimi i fshatares së pastër shqiptare Kristina në ditarin e një dezertori, përsëri nga këndvështrimi i “tjetrit”. Ajo shqiptare është aq tërheqëse, saqë nuk arrihet as të shpjegohet, as të zotërohet. Kjo bukuri e rrallë e prek dhe lëkund zemrën e tij, që të harronte përkohësisht rrezikun e luftës, çka e largon edhe pak lexuesin nga depresioni. Mjeshtëria e shtjellimit të autorit për detaje të imta spikat në mënyrë të natyrshme me një gjuhë koncize dhe të thukët. Kjo absolutisht përbën bukurinë gjuhësore dhe mendore e Kadaresë, një nga tiparet kryesore të stilit kadarean.

Një prirje që nuk duhet lënë mënjanë është që lexuesit ose shikuesit kinezë duan ta marrin romanin ose filmin për krahasim me ndonjë vepër artistike kineze

ose me fenomenet e shoqërisë kineze. Në krahasimet midis romanit *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* dhe filmit kinez *Sinjal grumbullimi*⁷, Luhe shpreh mendimin se protagonisti i romanit, gjenerali italian u kthye në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore për të kryer një mision humanitar, me mbledhjen e eshtrave të ushtarëve italianë, por vazhdimisht ndiente poshtërim dhe zymtësi, derisa përfundoi me çmenduri; ndërsa regjisori i filmit kinez na e kujton këtë personazh përmes kapitenit të kompanisë Gu Zi Di, që u kthye në fushën e betejës për të kërkuar arsytet pse shokët e tij të luftës dhanë jetën pa u njohur ende si dëshmor, për të kërkuar nderin dhe prehjen e të gjithëve.⁸ Vetëkuptohet se në ndonjë rast, çështjet që i interesojnë lexuesit, i tejkalojnë gjërat për të cilat flitet në veprën letrare, i kalojnë caqet e veprës që lexojnë. Çdo komentues ka liri të paraqitë idetë e tij, madje pa marrë parasysh që e tepron. Një shikues kinez, pas shumë vjetësh, përmend përsëri filmin *Kthimi i ushtrisë së vdekur*, për të theksuar një detaj se italianët ruajnë shumë hollësisht të gjitha shënimet mbi ushtarët e tyre.⁹ Natyrisht këto informacione të sakta janë një nga parakushtet vendimtare për gjetjen e eshtrave të tyre. Megjithatë, autori e përdor me ironi këtë detaj për të kritikuar mosekzistencën e njeriut në luftë dhe shndërrimin e tij në mjet. Ky lexues ka parasysh edhe faktin që viktimat kinezë gjatë Masakrës së Madhe të Nankinit në vitin 1937 nuk janë regjistruar me emra dhe numër të saktë, por jepen tashmë me një shifër të përgjithshme, të paqartë 300 mijë. Sigurisht ky nuk është problemi kyç që transmeton romani i Kadaresë, as vendi ku qëndron vlera e romanit, por shikuesit krijojnë subjektivisht ndonjë lidhje mes romanit dhe problemeve që kanë në vetvete, çka paraqet në një farë mënyre ndikimin e tërthortë të romanit mbi ta.

3.3 Karakteristikat e receptimit të veprës në mediat e reja kineze

Karakteristika e parë në receptimin e veprës *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* është individualiteti ose diversiteti. Qoftë vepra letrare, qoftë filmi artistik, sa më shumë e thellë, e shumëkuptimshme të jetë, aq më shumë komente të vlefshme ka për të. Veprat e Ismail Kadaresë shquhen për hapësira të mëdha diskutimi. Përveç komenteve të gjata të sipërpërmendura, në internet do të hasim edhe komente shumë të shkurtra, por interesante. Vlen të përmenden këtu ca komente të tilla. Njëri thotë se “romani është i zhytur në luftë, por pa e përshkruar direkt”¹⁰; tjetri

⁷ Ky film është shfaqur në Kinë në vitin 2007, me regjisorin e njohur kinez Feng Xiao Gang. Filmi flet për një histori gjatë Luftës Civile Çlirimtare, viteve 1945-1949, kapiteni i kompanisë Gu Zi Di zbatoi detyrën për të mbuluar tërheqjen e forcave kryesore. Gjatë betejës së ashpër, vetëm ai mbeti i gjallë, 47 shokët e luftës u cilësuan si të zhdukur, pasi nuk kishte mbetur asnjë shenjë prej tyre. Pas luftës, ai filloi të kërkonte të vërtetën nëse ishte dhënë sinjali tërheqës, pasi forcat kryesore kishte dalë jashtë rrezikut, ashtu siç ishte paralajmëruar kur kompanisë iu dha detyra e mbulimit të tërheqjes.

⁸ Luhe, *Dhimbjet që nuk u shuan nga koha*, i publikuar në datën 17 dhjetor 2008, në www.book.douban.com.

⁹ Zhao Mu, *Çdo shpirt i vdekur ka pasur emër*, i publikuar në datën 7 dhjetor 2004 në blogun e tij www.zhaomu.blog.sohu.com.

¹⁰ Clomer, *Romani me temën e luftës pa përshkruar luftën*, i publikuar në datën 6 mars, 2015, në www.book.douban.com.

Receptimi i *Gjenerali të ushtrisë së vdekur* në mediat e reja kineze

thotë se “Gjenerali nuhaste erën e vdekjes pranë vendeve ku u varrosën ushtarët e tyre”¹¹ etj. Ka raste kur në uebsajtin “www.book.douban.com”, komentet bëhen me pak fjalë, si për shembull, njëri thotë se “në tërë librin binte shi”, tjetri thotë se “është historia e një trupi pa jetë në kërkim të një togu eshtrash”.

E dyta karakteristikë është ndërveprimi në vazhdimësi. Receptimi i një veprë letrare në mediat e reja përbën vetë një proces të gjatë dhe të vazhdueshëm pas botimit të veprës. Paraqitja e mendimeve personale në internet për të komunikuar librat e lexuar me grupe shoqërore ose me njerëz me të njëjtën prirje pëlqimi, janë shndërruar në një mënyrë të kohës. Në këtë proces, me ngritjen e numrit të lexuesve, pasurohet edhe receptimi në tërësi. Përveç kësaj, efekti i receptimit ruhet automatikisht dhe referohet në çdo moment për të interesuarit. Versioni i vitit 1992 i *Gjenerali të ushtrisë së vdekur* në faqen letrare “www.book.douban.com” ka marrë 16 komente, kurse versioni i vitit 2008 po i këtij romani 111 komente.¹² Si efekti i topit të dëborës që rrokulliset, komentet lidhen direkt me veprat përkatëse, pastaj komentet mbi komente, qoftë mbështetje qoftë kundërshtime, ndërveprimet shtrihen ndër lexues, kritikë, dhe në fund formohet një debat i caktuar me një numër të konsiderueshëm pjesëmarrësish, si në shumë raste të forumit www.book.douban.com, ku reflektimet e lexuesve kanë ushtruar një ndikim të fortë mbi lexuesit e rinj për të vendosur nëse marrin ndonjë libër për vete. Edhe këta lexues pasardhës do të japin komente për të, prandaj receptimi i ndonjë veprë si *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* në internet mund të zhvillohet pa fund.

E treta karakteristikë është promovimi. Megjithatë pjesëmarrësit e kësaj faqeje letrare nuk kanë qëllim të caktuar fitimprurës, vetë faqja synon që të zgjerojë ndikimin e saj në fushën e letërsisë, madje jep linkun e adresës së shitësit në internet për promovimin e veprave të diskutuara. Për këtë arsye, zakonisht në vendet më të spikatura, jepen informacione të hollësishme për librat, si shtëpia botuese, autori, viti i botimit, faqet gjithsej, çmimi dhe sondazhet e pëlqimit të lexuesve. Si model i sprovuar promovimi, në këto faqe mund të gjendet edhe një paraqitje e shkurtër për autorin, përmbajtjen e librave të tij, madje në ndonjë rast edhe fragment prej veprave më të shitura. Në të njëjtën kohë, në fund të faqes, ofrohen edhe disa vepra të tjera që parashikohet se do të pëlqehen nga ata që e duan këtë vepër. Për shembull, në faqen e veprës *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, rekomandohen edhe veprat e tjera të Kadaresë *Kronikë në gur*, *Darka e gabuar*, *Vetëdija e Zenos* e shkrimtarit italian Italo Svevo, *Palltoja magjike* e autorit italian Dino Buzzati. Është vërtetuar se ky model, duke bashkuar nevojën e mtejshme të lexuesve me kërkesat e biznesit për shitjen e librave, arrin suksese më të madhe sesa modeli jashtë modës, ku jepen thjesht informacione librash.

¹¹ Luoshun, *Vdekja dhe ndjenja e vdekjes në hijen e luftës*, i publikuar në datën 5 gusht, 2009 në www.book.douban.com, i cili më parë u botua edhe në një gazetë jugore *Gazeta e punonjësve të Yangchengut*.

¹² Sasia e komenteve të lidhura me të është shënuar deri në datën 25 qershor 2015.

4. Konkluzion

Duke u nisur nga receptimi i veprës *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* në mediat e reja kineze, ne e dimë qartë se është zgjeruar gradualisht në Kinë ndikimi i veprave të Ismail Kadaresë. Dëshmitë e shumta për receptimin e veprës janë dhënë dhe do të jepen më shumë në mediat e reja. Dihet se receptimi i një vepre në internet nuk mund të ndodhë pa përkthimin ose botimin e veprave në formën tradicionale, por për shkak se mediat e reja kanë pasur një audiencë më të re, grupet më aktive shoqërore, të cilët janë më të lëvizshëm, më të lirë, më dinamikë, prandaj studimi i receptimit të një vepre në internet mund të dëshmojë në një farë mënyre gjendjen e përgjithshme të receptimit të saj. Fjala vjen, ky receptim në internet është më real, më i drejtpërdrejtë, i pandikuar shumë nga faktorët e tjerë objektivë. Qoftë vlerësimi, qoftë nënvlerësimi, mund të ketë hapësira për t'u shprehur. Jo vetëm kinezët, por edhe popujt e tjerë në botë janë me fat të bardhë sot, nuk do të jenë pak të vetmuar, por do të ndajnë nëpërmjet internetit kuriozitete për letërsinë dhe artin shqiptar. Sigurisht, prezantimi dhe njohja e kinezëve me shkrimtarin e shumëkuptimshëm Ismail Kadare janë ende shumë të kufizuara dhe në fazë fillestare. Veprat e këtij shkrimtari të shquar janë një temë diskutimesh shumë interesante e aktive dhe për këtë interneti ofron mundësi të paskajshme.

BIBLIOGRAFI

- K. Jing, *The Four Others in I.Kadare's Works - A Study of the Albanian National Identity*, Foreign Language Teaching and Research Press, Beijing, 2014.
- I. Kadare, Zhen En Bo (përkthyes), *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* në versionin kinez, Shtëpia Botuese Shkrimtari, Pekin, 1992.
- I. Kadare, Sun Shu Hui (përkthyes), *Prilli i thyer* në versionin kinez, Shtëpia botuese Chongqing, Chongqing, 2007.
- I. Kadare, Zhen En Bo (përkthyes), *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* në versionin kinez, Shtëpia botuese Chongqing, Chongqing, 2008.
- I. Kadare, Gao Xing (përkthyes), *Pallati i ëndrrave* në versionin kinez, Shtëpia botuese Chongqing, Chongqing, 2009.
- I. Kadare, Li Yu Min (përkthyes), *Kronikë në gur* në versionin kinez, Shtëpia botuese Huacheng, Guangzhou, 2012.
- I. Kadare, Yu Zhong Xian (përkthyes), *Darka e gabuar* në versionin kinez, Shtëpia botuese Huacheng, Guangzhou, 2012.
- I. Kadare, Zou Yan (përkthyes), *Kush e solli Doruntinën* në versionin kinez, Shtëpia botuese Huangcheng, Guangzhou, 2012.
- www.cnki.net
- www.book.douban.com
- www.blog.sina.com.cn